



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 47 prot.

Kamëz, më 13.042021

V E N D I M

Nr. 39 Datë 13.04 .2021

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIMNË LISTËN E INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORETË TRANSFERUARA NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË KAMËZ

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **13.04.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt – Vendimin Nr.34 Datë 12.04.2021**, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.20/2020 “Përpërfundimin e proceseve kalimtare tëpronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 “Përpronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.02.2021 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit nënjësitë e qeverisjes vendore”, tëndryshuar, tëVKM-së nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë”, të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz, nr.83, datë 17.07.2020 “Për miratimin e shembjes së ndërtesave kolektive (pallatet) në Valias, Kamëz si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26.11.2019”, Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, **Këshilli Bashkiak Kamëz**:

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për ndryshimin e sipërfaqes nga 500,000 (pesëqind mijë) m² në 50,000 (pesëdhjetë mijë) m², të pasurisë “Ish-Miniera Valias” si dhe transferimin e kësaj pasurie në pronësi të Bashkisë Kamëz, pasqyruar me numër rendor 1637 në Listën e Inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore të transferuara në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kamëz me VKM-në nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e

listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë”, sipas hartës kadastrale, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Miratimin e kërkesës për shtimin në Listën e Inventarit, të pasurisë nr.34, të pasqyruar në fletën e inventarit me numër rendor 1810, me sipërfaqe 23 520 (njëzet e tre mijë pesëqind e njëzetë)m², sipas planit të rilevimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Tokës, Përmirësimit në Mjedis, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave si dhe Kryetari i Bashkisë Kamëz.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli

